



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 15.3.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Verica Çeraniq, kryetare, Hydajet Hyseni Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Drita Millaku, Shemsedin Dreshaj, Valentina Bunjaku Rexhepi, Miljana Nikoliq, Zoran Mojsiloviq, Jasmina Dediq, Milosh Peroviq, Adem Hodzha, Fadil Gashi dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Arjeta Fejza, Elmi Reçica, Enis Kervan dhe Fridon Lala.

Të pranishëm të tjerë: Mirishahe Tasholli- KDI; Fiona Beka, asistente e GP VV; Arton Musliu- asistent i GP PDK; Zijush Ahmeti-SKKK dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Verica Çeraniq**, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me dt. 23.2.2022 dhe 2.3.2022.**
- 3. Formimi i grupeve të punës për monitorimin e Ligjeve;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me dt. 23.2.2022 dhe 2.3.2022

Kryetarja, theksoi se para vetës i kemi dy procesverbale, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të ofrojnë ndonjë propozim apo vërejtje eventuale.

Hydajet Hyseni Kaloshi, tha se nuk ka vërejtje për rendin e ditës dhe se procesverbalet janë të hartuara mirë. Mirëpo në procesverbalin e datës 23.02.2022, është bërë një lëshim. Në pjesën ku kam dhënë propozimin që të organizohet një tryezë ose konferencë për bashkëpunim rajonal, të fshihen fjalët “për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve” dhe zëvendësohen me fjalinë shkëmbim i përvojave të dy anshme, në mbështetje të partneritetit ndërkombëtar të cilët e përkrahin punë e komisionit.

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet do të shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen e radhës, pasi të inkorporohet propozimi i dhënë nga z. Hyseni.

3. Formimi i grupeve të punës për monitorimin e Ligjeve;

Kryetarja, theksoi se një ndër përgjegjësit e komisionit është që të fillohet me procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Mbikëqyrja do të bazohet në Planin e punës për vitin 2022, ku Komisioni do të monitorojë zbatimin e tre Ligje, si në vijim:

1. Ligji për Vetëqeverisje Lokale.
2. Ligji për përdorimin e gjuhëve.
3. Ligji për zyrtarët publikë (neni 9).

Në kuadër të monitorimit dhe zbatimit të tre ligjeve, Komisioni do të formojë tre grupe punuese, dhe secili grup do të ketë nga gjashtë anëtarë.

Në secilin grup punues do të emërohet kryesuesi, si bartës i procesit të monitorimit të Ligjeve dhe i cili do t’ i udhëzojë për procedurat e mbajtjes së takimeve.

Ajo tha se në secilin grup punues do të jenë të përfaqësuar nga: dy anëtarë të GP të LS, dy anëtarë të GP shumicë dhe dy anëtarë të GP multietnik.

Sa i përket anëtarëve të LS-së, propozoi që në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dy anëtarë; Verica Çeraniq dhe Zoran Mojsilović.

Në grupin punues për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, propozoi dy anëtarë: Miljana Nikoliq dhe Jasmina Dediq dhe në grupin punues për monitorimin e Ligjit për zyrtarët publikë (neni 9), propozoi dy anëtarë: Milosh Peroviq dhe Verica Çeraniq.

Sa i përket anëtarëve të GP multietnik, propozoi këtë përbërje; në grupin punues për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisja Lokale, Bekim Arifi, për monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve Enis Kervan, dhe për monitorimin e Ligjit për Zyrtarë Publikë (neni 9) Bahrim Shabani.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, morri iniciativën të formohen 3 grupe punuese për monitorimin dhe zbatimin e 3 ligjeve, si në vijim:

- I. Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me këtë përbërje:
Kryesuese, Verica Çeraniq, anëtarë tjerë: Zoran Mojsiloviq, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Bahrim Shabani, Adem Hoxha, Fadil Gashi dhe Valentina Bunjaku- Rexhepi.
- II. Grupi punues për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, me këtë përbërje:
Adem Hoxha, kryesues, Miljana Nikoliq, Jasmina Dediq, Arjeta Fejza dhe Enis Kervan, anëtarë.
- III. Grupi punues për monitorimin dhe zbatimit të Ligjit për zyrtarët publikë (neni 9), me këtë përbërje:
Milosh Peroviq, kryesues, Bahrim Shabani, Drita Milaku, Shemsedin Dreshaj dhe Verica Çeraniq, anëtarë.

Kryetarja, konstatoi se struktura e grupeve punuese, do të plotësohen dhe ndryshohen në mbledhjen e radhës, me ç ‘rast do të janë prezentë edhe anëtarët e GP të LVV dhe GP të PDK, të cilët do të deklarohen personalisht të jenë pjesë e grupeve punuese.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor. Komisioni funksional si komision raportues, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2022, ka hartuar rekomandimin për të cilin nuk ka propozuar amendamente, dhe ka vendosur që raportin t’ ua procedojë komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Pasi nuk pati propozime shtesë, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 4 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në votim, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi. Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2022, doli me rekomandim i cili nuk ka propozuar amendamente, dhe ka vendosur që raportin t'ua procedojë komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Pasi nuk pati propozime shtesë, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 6 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në votim, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2022, doli me rekomandim i cili nuk ka propozuar amendamente, dhe ka vendosur që raportin t'ua procedojë komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Pasi nuk pati propozime shtesë, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 6 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në votim dhe nxori këtë:

Përfundim

- I. Projektligji nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Hydajet Hyseni-Kaloshi, tha se pasi është anëtar edhe në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, dhe në të njëjtën kohë është duke u mbajtur takimi, për këtë arsye më duhet të vazhdojë të marr pjesë në këtë takim.

Sipas pikës 7 dhe 8 të rendit të ditës, ai deklarohet se vota e tij është pro, miratimit të dy Projektligjeve.

Kryetarja, theksoi se vota është valide, vetëm në rastet kur anëtari i komisionit është prezent.

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale. Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2022, doli me rekomandim i cili nuk ka propozuar amendamente, dhe ka vendosur që raportin t'ua procedojë komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Kryetarja, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 5 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në votim, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike, me raport të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-78 për shëndetësi publike. Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2022, dhe doli me rekomandim i cili nuk ka propozuar amendamente, dhe ka vendosur që raportin t'ua procedojë komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Kryetarja, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 5 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në votim, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-78 për Shëndetësi Publike, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisioni funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe të njëjtin nuk e miratoi sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.

9. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.
E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Verica Çeraniq,
Kryetare e Komisionit
